



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL. Anr.439/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët Ramush Bardiqi, kryesues, Hidajete Gashi Alaj dhe Kujtim Pasuli anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, lidhur me parregullsitë gjate procesit të numërimit të fletëvotimeve në Komunën e Mitrovicës së Jugut, për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve Lokale të mbajtura me datë 09.11.2025, për Kryetar të Komunës së Mitrovicës së Jugut, në seancën e panelit të mbajtur, më datë 14.11.2025, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, me te cilën ka kërkuar qe te urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), që brenda afatit të caktuar ligjor, të përsërisë procesin zgjedhor në Komunën e Mitrovicës së Jugut, duke kryer rivotim në përputhje me ligjin dhe rregulloret përkatëse.

A r s y e t i m

Më datë 11.11.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesë nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë me të cilën thekson se me këtë ankesë, paraqesim parregullsitë e konstatuara gjatë procesit të numërimit të fletëvotimeve në Komunën e Mitrovicës së Jugut, dhe se thelbi i kësaj anekese lidhet me faktin se fletëvotimet janë gjetur të përziera ndërmjet klasave dhe shkollave të ndryshme, pra nuk është respektuar përputhja me kodet unike të vendvotimeve. Kjo ka rezultuar në situata ku fletëvotimet të destinuara për një vendvotim janë gjetur në kutitë e një vendvotimi tjetër, brenda të njëjtës qendër votimi apo edhe në qendra të tjera votimi, konkretisht, rastet e konstatuara janë: në vendvotimin 1103/04 është gjetur një fletëvotim i vendvotimit 1102/10; në vendvotimin 1102/11 është gjetur një fletëvotim i vendvotimit 1102/10 (gjithashtu, fletëvotimi është i vulosur dy herë që tregon për "trenin bullgar"); në vendvotimin 1102/6 është gjetur një fletëvotim i vendvotimit 1102/05, fletëvotimi i Qendrës së Votimit 1102 të vendvotimit numër 5 (Shkolla "Abdullah Shabani") është hasur në vendvotimin numër 6 të njëjtës Qendër Votuese; fletëvotimi i Qendrës së Votimit 1102 të vendvotimit numër 1 (Shkolla "Abdullah Shabani") është hasur në vendvotimin numër 4 të Qendrës Votuese 1103 (Universiteti "Isa Boletini; fletëvotimi i vendvotimit numër 13 të Qendrës Votuese 1101 (Shkolla "Mixheni") është hasur në kutinë e

vendvotimit numër 5 të Qendrës Votuese 1102 (Shkolla "Abdullah Shabani"); fletëvotimi i Qendrës së Votimit 1102 të vendvotimit numër 1 (Shkolla "Abdullah Shabani") është hasur në vendvotimin numër 5 të njëjtës Qendër Votuese; fletëvotimi i Qendrës së Votimit 1102 të vendvotimit numër 4 (Shkolla "Abdullah Shabani") është hasur në vendvotimin numër 5 të njëjtës Qendër Votuese; fletëvotimi i vendvotimit numër 5 të Qendrës së Votimit 1103 (Universiteti "Isa Boletini") është hasur në kutinë e vendvotimit numër 1 të Qendrës së Votimit 1104 (Shkolla "Ismail Qemali").

Tutje në ankesë theksohet se në këtë komunë, po ashtu, është vërejtur një fenomen i pazakontë edhe shqetësues, pjesëmarrja e votuesve në raundin e balotazhit ka rezultuar më e lartë se në raundin e parë, çka përbën rast unik në nivel të Kosovës dhe ngre dyshime serioze për manipulim elektoral dhe shtim artificial të votave. Gjithashtu, gjatë procesit të numërimit janë hasur shumë fletëvotime të pavulosura, ndërsa disa të tjera janë gjetur të vulosura dy herë, çka përforcon dyshimet për parregullsi të qëllimshme në procesin zgjedhor. Në ditën e votimit është ushtruar presion i paraparë mbi qytetarët e Mitrovicës, Një qytetar madje është detyruar të mbyllë kafenenë e tij, gjë që ai vetë e ka dëshmuar publikisht në një Deklaratë. Parashtruesi i ankesës thekson se këto parregullsi tregojnë qartë se procesi zgjedhor nuk ka qenë i lirë dhe i ndershëm, duke cenuar integritetin e votës dhe të drejtën e qytetarëve për të votuar në mënyrë të barabartë dhe të sigurt. Fakti që fletëvotimet janë manipuluar dhe disa janë gjetur të pavulosura ose të vulosura dy herë, dëshmon për ndërhyrje të qëllimshme dhe për një mungesë të standardeve të domosdoshme për zgjedhje të lira dhe të ndershme.

Me tutje ka shtuar se, fakti që ka mos-përputhje mes kodit të fletëvotimit dhe vendvotimit përbën shkelje ligjore, pasi fletëvotimi duhet të ketë kodin e vet unik që duhet të përputhet me vendvotimin, siç parashikohet në nenin 87, paragrafët 5, nën paragrafi 5.5. të Ligjit Nr. 080-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, aty thuhet: *"Fletëvotimi duhet të përmbajë tiparet e sigurisë, sikurse janë përcaktuar nga KQZ-ja. Me qëllim që kjo kërkesë e ligjit për sigurinë e fletëvotimeve të operacionalizohet, është nxjerrë Rregullorja Zgjedhore nr. 10/2024 për fletëvotimin dhe broshura e KQZ-së. Në nenin 5, paragrafi 5 përcaktohet: "Fletëvotimet kanë numrin serik, që shtypet në anën e sipërme të djathtë të pjesës amë e cila mbetet pas shpërndarjes së fletëvotimit. Numri serik është tetë shifror dhe fillon nga 01000000."* Ndërsa paragrafi 6 përcakton i po kësaj rregullore: *"Në fletëvotim shtypet kodi i vendvotimit (VV), që është kombinim i shkronjave dhe numrave që lidhen me fletëvotimin. Ky kod shënohet në pjesën e sipërme dhe të poshtme të fletëvotimit."*

Po ashtu, kjo bie ndesh edhe me Manualin për Procedurat e Votimit dhe Numërimit në Vendvotime, raundi i dytë, të KQZ-së. Pika 10 (10.22) përcakton se: *"Fletëvotimi konsiderohet i vlefshëm nëse ka numrin serik dhe VV përkatës."* E gjithë kjo është e paligjshme dhe me këtë është cenuar integriteti i procesit zgjedhor, të cilin e mbron Ligji Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Në nenin 59, paragrafi 4, nënparagrafi 4.45 përcakton: *"Gjatë zbatimit të mandatit të vet, KQZ-ja, inter alia: (...) kryen çdo funksion tjetër ndihmës për mbajtjen e zgjedhjeve në Kosovë që i përcaktohet me Rregulloret relevante dhe instrumentet ndihmëse, përfshirë veprimet e domosdoshme për mbrojtjen e integritetit të procesit zgjedhor në rast shfaqjeje të një force madhore"*. Pala ankuese po ashtu thekson se në përgjigje të KQZ-së, e cila ka theksuar se gjatë shtypjes së fletëvotimeve është bërë një gabim teknik. Por dhe nëse kjo është e vërtetë, ajo nuk e shmang

nevojën për rivotim dhe përsëritje të zgjedhjeve në Mitrovicë. Vetëm në këtë mënyrë mund të sigurohet që procesi zgjedhor të zhvillohet sipas ligjit, me fletëvotime të sigurta dhe të vlefshme. Shkeljet e konstatuara përzierja e fletëvotimeve ndërmjet shkollave dhe klasave të ndryshme, mos-përputhja me kodet unike të vendvotimeve, prania e fletëvotimeve të pavulosura ose të vulosura dy herë janë sistematike dhe jo rastësore. Rezultatet e vetëm disa vendvotimeve nuk mund të pasqyrojnë vullnetin real të qytetarëve, dhe një rivotim i pjesshëm nuk garanton një proces zgjedhor të lirë, të ndershëm dhe të sigurt. Pala ankuese ka bashkangjitur një CD me parregullsitë e pretenduara, librin e evidencës në QKN me shënimet nga kryesuesi dhe anëtarët e QKN-së, fletëvotime.

KQZ në përgjigjen në ankesë ka theksuar se, KQZ pas shqyrtimit të ankesës dhe pretendimeve të palës ankuese në lidhje me pretendimin ankimor për shkeljet ligjore të nenit 87, të Ligji Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 87 (Përshkrimi i fletëvotimit dhe materialit në lidhje me fletëvotimin), paragrafi 5, KQZ, me datë 08.03.2024, ka miratuar Rregulloren Zgjedhore Nr. 10/2024 për Fletëvotimet dhe Broshurat. Më pas, me datë 27.05.2025, është miratuar Rregullorja Zgjedhore Nr. 01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Zgjedhore Nr. 10/2024 për Fletëvotimet dhe Broshurat. Neni 5 (Detajet teknike të fletëvotimeve dhe broshurave) i Rregullores, përcakton detajet teknike të fletëvotimeve dhe broshurave si dhe paragrafi 5 dhe 6 thuhet: “5. Fletëvotimet kanë numrin serik, që shtypet në anën e sipërme të djathtë të pjesës amë, e cila mbetet pas shpëputjes së fletëvotimeve. Numri serik është tetë shifrorë dhe fillon nga 01000000. 6. Në fletëvotim shtypet kodi i Vendvotimit (VV), që është kombinim i shkronjave dhe numrave, e që ndërlidhë fletëvotimin me VV. Ky kod shënohet në pjesën e përparme të fletëvotimit.” Tutje ka theksuar se ZEKK në Mitrovicën e Jugut ka raportuar përmes emailit me datë 09.11.2025 lidhur me evidentimin e një fletëvotimi me kod 1110/02 në vendvotimin 1110/03, gjatë numërimit në vendvotim. Po ashtu, pas fillimit të verifikimit në QKN, me datë 10.11.2025, nga ZEKK në Mitrovicën e Jugut jemi njoftuar se Prokuroria Themelore në Mitrovicën e Jugut ka lëshuar Urdhëresë për ndërprerjen e verifikimit të votave në QKN, deri në pranimin e sqarimit nga Operatori Ekonomik “Cetis”. Ndërsa me datë 11.11.2025, KQZ ka pranuar sqarimin nga kompania Cetis, në të cilin thuhet se pas pranimit të fotografive që tregonin gabimin, kompania ka zhvilluar një hetim të plotë të procesit të prodhimit dhe përgatitjes së të dhënave. Hetimi ka zbuluar se problemi ka ndodhur vetëm në një nga katër kokat e printerit që shtyp kodin e vendvotimit. Për shkak se sistemi i kontrollit monitoron vetëm numrin serik (QR-kodin), ky gabim nuk është detektuar gjatë procesit të shtypjes. Më tej, Cetis thekson se merr plotësisht përgjegjësinë për këtë gabim teknik, duke nënvizuar se fletëvotimet përmbajnë elemente të shumta sigurie që e bëjnë të pamundur falsifikimin apo kopjimin e tyre.

Përmes përgjigjes në ankesë KQZ ka deklaruar se me datë 12.11.2025, ka themeluar Komisionin prej 8 zyrtarëve të Sekretariatit të KQZ-së për vlerësimin e fletëvotimeve dhe përputhjes së numrit të fletëvotimeve në vendvotime për Zgjedhjet për Raundin e Dytë Kryetar Komune, me qëllim të evidentimit të çështjeve të raportuara nga KKZ në Mitrovicën e Jugut dhe në funksion të përgjigjes për PZAP lidhur me këtë ankesë. Komisioni ka nisur punën më 12.11.2025, ndërsa në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve ka vazhduar aktivitetet më 13.11.2025, duke hapur dhe shqyrtuar gjithsej 105 kuti të votimit nga vendvotimet e rregullta të komunës së Mitrovicës së Jugut. Gjatë procesit të vlerësimit,

komisioni ka bërë hapjen dhe verifikimin e të gjitha kutive të votimit, duke numëruar dhe analizuar fletëvotimet e papërdorura dhe ato të përdorura, si dhe duke evidentuar fletëvotimet me gabime në shtypje. Është bërë kontrolli i origjinalitetit të fletëvotimeve të përdorura përmes pajisjeve përkatëse, si dhe është kryer shqyrtimi i statistikave të secilit vendvotim. Sipas Raportit, të Komisionit, si rezultat i procesit të verifikimit, Komisioni ka ardhur në përfundimet si vijon: Vendvotimet në të cilat është konstatuar shtypja e kodit të gabuar të vendvotimit në fletëvotime janë: 1101/01, 1101/02, 1101/03, 1101/04, 1101/06, 1101/07, 1101/08, 1101/09, 1101/11, 1101/12, 1101/13, 1102/01, 1102/03, 1102/04, 1102/05, 1102/06, 1102/08, 1102/09, 1102/10, 1102/11, 1103/03, 1103/04, 1103/05, 1104/01, 1104/04, 1104/05, 1104/06, 1105/02, 1105/03, 1105/04, 1105/05, 1106/03, 1106/04, 1106/05, 1107/02, 1107/03, 1107/04, 1108/01, 1109/02, 1109/03, 1109/04, 1109/05, 1110/01, 1110/02, 1110/03, 1110/04, 1110/07, 1111/01, 1111/02, 1111/05, 1111/06, 1112/01, 1113/01, 1114/01, 1115/01, 1116/01, 1116/02, 1116/05, 1117/01, 1118/01, 1118/02, 1120/01, 1120/02, 1121/01, 1122/01, 1122/02, 1124/02, 1125/01, 1126/01, 1127/01, 1128/01, 1129/01, 1129/02, 1130/01.

Nga verifikimi rezulton se gjithsej 124 fletëvotime nuk kanë kodin përkatës të vendvotimit, pra kodi është shtypur gabim. Nga këto, 116 fletëvotime e kanë të shtypur kodin e një vendvotimi tjetër, ndërsa 8 fletëvotime nuk kanë të shtypur fare kod të vendvotimit. Tek fletëvotimet e papërdorura janë identifikuar 84 dengje (batch-e) në të cilat janë evidentuar fletëvotime të shtypura me kod të gabuar (76 fletëvotime) dhe pa kod (8 fletëvotime). Në të gjitha këto raste, gabimi paraqitet tek fletëvotimi i fundit i dengut. Ndërsa tek fletëvotimet e përdorura janë identifikuar 40 fletëvotime të cilat kanë kodin e vendvotimit tjetër. Prej tyre, në 18 fletëvotime është votuar për kandidatin me numër 105, Faton Peci–Lëvizja Vetëvendosje, ndërsa në 22 fletëvotime është votuar për kandidatin me numër 191, Arian Tahiri–Partia Demokratike e Kosovës (PDK). Numri i fletëvotimeve të shtypura për 105 vendvotimet në 32 qendrat e votimit të rregullta është 72750, ashtu sikurse është përcaktuara me vendimin e KQZ-së. Kjo sasi është pranuar nga KKZ, dhe secili nga 105 Këshillat e Vendvotimeve ka pranuar sasinë sikurse është përcaktuar nga KQZ dhe shtypur nga kontraktori.

Përmes përgjigjes në ankesë KQZ-ja ka theksuar se, Raporti i pranuar nga Cetis më 11.11.2025, pas auditimit të pajisjeve, në të cilin janë identifikuar 74 vendvotimet ku mund të jenë paraqitur gabimet, numrat serikë të dengjeve përkatëse dhe lloji i gabimit për secilin rast (kod i vendvotimit i shtypur gabim ose i lënë zbrazët), përputhet plotësisht nga gjetjet si rezultat i verifikimit të bërë nga Komisioni me date 13.11.2025 në QNR, pas hapjes së 105 kutive të votimit në vendvotimet e Mitrovicës së Jugut. Në të gjitha vendvotimet numri i fletëvotimeve të vlefshme, të pavlefshme dhe të dëmtuara përputhet me numrin e fletëvotimeve të pranuar nga Këshilli i Vendvotimi. Numrat serikë të dengjeve (amave) të fletëvotimit përputhen me numrat serikë të pranuar dhe të destinuara për secilin vendvotim. Në asnjë vendvotim nuk është gjendur ndonjë fletëvotim tjetër përveç atyre të shtypura nga KQZ (origjinale) bazuar në librat e votimit të evidentuar nga Këshillat e Vendvotimeve, librat e evidencës së Ekipeve të Numërimit, Raportit të KKZ-së dhe verifikimeve të bëra nga Komisioni. Andaj, KQZ sqaron se, në kontekstin e elementeve të sigurisë, kodi i vendvotimit nuk përbën element sigurie të fletëvotimit, sipas përcaktimeve të nenit 5, paragrafi 3, të Rregullores Zgjedhore Nr. 10/2024 për Fletëvotimet dhe Broshurat, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Zgjedhore Nr. 01/2025.

Ashtu siç është sqaruar më sipër, KQZ sqaron se gabimi i evidentuar është ekskluzivisht teknik dhe i kufizuar në shtypjen e kodit të vendvotimit në disa fletëvotime të fundit brenda disa dengjeve, përfshirë edhe ato të përdorura, në të cilat janë evidentuar preferencat e votuesve për të dy kandidatët. Asnjë nga fletëvotimet e dedikuara për vendvotim nuk janë bartur në vendvotime tjera, por që për shkak të gabimeve në printim siç e kemi shpjeguar më lartë, kanë qene pjese e dengjeve. Për të ekzistuar i ashtuquajti "tren bullgar", do të duhej që ndonjë fletëvotim të mungoj apo të gjendet ndonjë fletëvotim i falsifikuar, çka në rastin konkret nuk ka ndodhur, të gjitha fletëvotimet janë origjinale të vendvotimeve dhe përmbajnë të gjitha elementet e sigurisë të përcaktuara me rregulloren e KQZ. Gabimet e evidentuara nuk kanë ndikuar në asnjë mënyrë në integritetin e procesit të votimit dhe as në rezultatin zgjedhor, sepse votuesve iu është dhënë fletëvotimi të cilën e kanë plotësuar duke e shprehur vullnetin e tyre dhe duke e futur në kutin e votimit. Si prove ka bashkangjitur përgjigjen e Operatorit Ekonomik CETIS të datës 11.11.2025, si dhe një raport i pranuar nga CETIS me gabimet e evidentuara pas auditimit që e kanë bërë në pajisjet (sistemit të printimit) me date 12.11.2025.

Paneli pasi, analizoi dhe vlerësoi të gjitha provat nga shkresat e lëndës, ka gjetur se:

- Ankesa është e pabazuar

Pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore dhe përgjigjes në ankesë të KQZ-së, Paneli vlerësoj se pretendimet në ankesën e parashtruar nga subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me të cilën pretendohet se fletëvotimet e destinuara për një vendvotim janë gjetur në kutitë e një vendvotimi tjetër, brenda të njëjtës qendër votimi apo edhe në qendra të tjera votimi, pra nuk është respektuar përputhja me kodet unike të vendvotimeve konkretisht, rastet si: në vendvotimin 1103/04 është gjetur një fletëvotim i vendvotimit 1102/10; në vendvotimin 1102/11 është gjetur një fletëvotim i vendvotimit 1102/10 (gjithashtu, fletëvotimi është i vulosur dy herë që tregon për "trenin bullgar"); në vendvotimin 1102/6 është gjetur një fletëvotim i vendvotimit 1102/05, fletëvotimi i Qendrës së Votimit 1102 të vendvotimit numër 5 (Shkolla "Abdullah Shabani") është hasur në vendvotimin numër 6 të të njëjtës Qendër Votuese; fletëvotimi i Qendrës së Votimit 1102 të vendvotimit numër 1 (Shkolla "Abdullah Shabani") është hasur në vendvotimin numër 4 të Qendrës Votuese 1103 (Universiteti "Isa Boletini"; fletëvotimi i vendvotimit numër 13 të Qendrës Votuese 1101 (Shkolla "Migjeni") është hasur në kutinë e vendvotimit numër 5 të Qendrës Votuese 1102 (Shkolla "Abdullah Shabani"); fletëvotimi i Qendrës së Votimit 1102 të vendvotimit numër 1 (Shkolla "Abdullah Shabani") është hasur në vendvotimin numër 5 të njëjtës Qendër Votuese; fletëvotimi i Qendrës së Votimit 1102 të vendvotimit numër 4 (Shkolla "Abdullah Shabani") është hasur në vendvotimin numër 5 të të njëjtës Qendër Votuese; fletëvotimi i vendvotimit numër 5 të Qendrës së Votimit 1103 (Universiteti "Isa Boletini") është hasur në kutinë e vendvotimit numër 1, të Qendrës së Votimit 1104 (Shkolla "Ismail Qemali"). Gjithashtu edhe pretendimet e ankuesit lidhur me nenin 59 dhe 87, paragrafët 5, nën paragrafi 5.5. të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës si dhe pretendimet tjera të përshkruar në ankesë, janë të pabazuara.

Paneli në baze të provave të prezantua nga pala ankuese, përgjigje në ankesë nga KQZ, dhe raportit nga Kompania Cetis, vlerëson se pretendimet ankimore janë të paqëndrueshme për arsye se, ankuesi nuk ka prezantuar prova për të dëshmuar këto parregullsi, ndërsa nga përgjigja se KQZ-se, rezulton se ky institucion për te vlerësuar parregullsitë e pretenduara ka themeluar Komision të veçantë, ku pas vlerësimit dhe verifikimit, nga hapja dhe shqyrtimi 105 kutive të votimit nga Vendvotimet në këtë Komunë dhe pas numërimit dhe analizimit të fletëvotimeve të papërdorura dhe ato të përdorura si dhe duke evidentuar fletëvotimet me gabime, është nxjerr përfundimi se në gjithsej 124 fletëvotime nuk kanë kodin përkatës të vendvotimit përkatësisht kodi është shtypur gabim, nga këto 116 fletëvotime e kanë të shtypur kodin e një vendvotim tjetër, ndërsa 8 fletëvotime nuk kanë të shtypur fare kodin e vendvotimit. Nga këto fletëvotime 40 janë përdorur e te cilat e kane kodit fletëvotimit tjetër, prej këtyre 40 fletëvotimeve, 18 prej tyre i përkasin kandidatit nr. 105, Faton Peci-Lëvizja Vetëvendosje, ndërsa 22 fletëvotime është votuar për kandidatin me numër 191, Arian Tahiri-Partia Demokratike e Kosovës (PDK. Përveç kësaj nga hetimi i bërë nga KQZ-ja ka rezultuar se në të gjitha vendvotimet numri i fletëvotimeve të vlefshme, të pavlefshme dhe të dëmtuara përputhet me numrin e fletëvotimeve të pranuar nga Këshilli i Vendvotimit. Numrat serik të dengjeve (amave) të fletëvotimit përputhen me numrat serik të pranuar dhe të destinuara për secilin vendvotim. Në asnjë vendvotim nuk është gjendur ndonjë fletëvotim tjetër përveç atyre të shtypura nga KQZ (originale) bazuar në librat e votimit të evidentuar nga Këshillat e Vendvotimeve, librat e evidencës së Ekipeve të Numërimit, Raportit të KKZ-së dhe verifikimeve të bëra nga Komisioni.

Paneli vlerëson si të pabazuar pretendimin e ankuesit lidhur me shkeljet e nenin 87 parag. 5 nenparag. 5 të LZP, e që ka të bëjë me fletëvotimet, përkatësisht tiparet e sigurisë, kjo pasi që fletëvotimi i përmban tri veçorit të sigurisë Mikroshtypi, UV Print, Anticopy, e te cilat janë përcaktuar me neni 5 të rregulloren zgjedhore 10/2024 dhe plotësim ndryshimi i kësaj rregullore 01/2025. Këto tipare të sigurisë i ka përcaktuar KQZ me akte nënligjore, e te cilat burojnë nga neni 87 parag. 5 i LZP. Nga kjo rezulton se kodi i vendvotimit nuk përben element sigurisë së fletëvotimit, kjo pasi që numri serik i fletëvotimeve ka qenë në rregull dhe i saktë, por që gabimi teknik ka ndodh me kodin e vendvotimit. Andaj, nga kjo dhe sqarimi i dhënë nga kompania CETIS, me date 11.11.2025, rezulton se gabimi është vetëm teknik ndërsa fletëvotimet përmbajnë elemente të shumta të sigurisë që e bëjnë të pamundur falsifikimin apo kopjimin e tyre, duke sqaruar se problemi ka ndodhur vetëm në një nga katër kokat e printerit që shtyp kodin e vendvotimit.

Paneli vlerëson se në këtë rast nuk është cenuar integriteti i zgjedhjeve, kjo pasi që nga provat e ekzistuese rezulton se ka ekzistuar vetëm gabim teknik në kodin e fletëvotimit në vendvotim, ndërsa numri serikë dhe elementet e tjera që kanë qenë të domosdoshme për sigurinë e fletëvotimit kanë ekzistuar në secilin fletëvotim, ashtu siç është përcaktuar edhe me Rregulloren Zgjedhore KQZ-së 10/2024 fletëvotimet dhe Broshurat dhe plotësim ndryshimi i kësaj Rregullore me Rregulloren nr. 01/2025.

Sa i përket pretendimeve të palës ankuese për dërgimin në rivotim dhe përsëritjen e zgjedhjeve në gjithë territorin e Mitrovicës së Jugut, Paneli vlerëson se ky pretendim është i pa themeltë, pasi që në rastin konkret përmes provave të administruara nuk është arritur të provohet se ka shkelje të Ligjit të Zgjedhjeve apo të Rregullave të KQZ-së, me cilën është

cenuar integriteti i zgjedhjeve apo të ketë ndikuar në rezultatin zgjedhor për Kryetar të Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Paneli vlerëson se është i pabazuar pretendimi ankimor për bartjen e votave nga një qendër në qendër tjetër, për arsye se, e gjithë kjo ka ndodhur për shkak të gabimit teknik në kodin e fletëvotimit, pasi që është konstatuar se nuk ka pasur fletëvotime tjera përveç atyre të shtypura, sepse numri i fletëvotimeve të shtypura për 105 vendvotime në 32 qendrat e votimit të rregullta, ka qenë 72750 fletëvotime, e cila sasi është pranuar nga Këshillat e vendvotimeve sipas vendimit të KQZ-së, e që nënkupton se nuk ka pasur më tepër fletëvotime se ato të cilat i ka shtypur kontraktori - Kompania Cetis.

Lidhur me pretendimin për të ashtuquajturin “Trenin Bullgar”, Paneli vlerëson se nuk qëndron një pretendim i tillë, për faktin se me asnjë provë nuk është vërtetuar se në rastin konkret të ketë mungesë të ndonjë fletëvotimi apo të ketë ndonjë fletëvotim të falsifikuar, ndërsa në anën tjetër është vërtetuar se të gjitha fletëvotimet janë origjinale dhe të njëjtat i përmbajnë të gjitha elementet e sigurisë të përcaktuar sipas Rregullave të KQZ-së. Po ashtu paneli vlerëson se në të gjitha vendvotimet numri i fletëvotimeve të vlefshme dhe të pavlefshme si dhe atyre të dëmtuar përputhet me numrin e pranuar nga këshilli i vendvotimit si dhe numrat serik të dengjeve të fletëvotimit përputhen me numrat serik të pranuar dhe destinuar për secilin vendvotim. Gjithashtu në asnjë vendvotim ku janë hasur fletëvotime me gabime teknike nuk është gjetur asnjë fletëvotim tjetër përveç atyre të shtypura nga ana e KQZ-së, andaj pretendimet e subjektit ankues në këtë drejtim janë vlerësuar të pa bazuara.

Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, Paneli vendosi që të refuzoj si të pabazuar, ankesën e ankuesit për arsye se, ankuesi nuk ka dëshmuar me prova konkrete pretendimet e ngritur në ankesën për rivotim, ndërsa me provat e prezantuar nuk ka arritur të përmbushë standardin e kërkuar ligjor për të konstatuar se ka pasur cenim të procesit zgjedhor e i cili do të kishte ndikim në rezultatin për raundin e dytë të zgjedhjeve lokale për Kryetar të Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet se *“Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.439/2025 datë 14.11.2025



Kryesues i Panelit
Ramush Bardiqi

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

AA.nr.122/2025

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Faton Bajrami, kryetar, Franciska Zhitija - Ymeri dhe Lumni Sallauka anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga subjekti politik: Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZL.Anr.439/2025, të datës 14.11.2025, lidhur me parregullsitë gjatë procesit të numërimit të fletëvotimeve në raundin e dytë për Kryetar të Komunës së Mitrovicës së Jugut, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, të mbajtura më datë 09 nëntor 2025, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 20.11.2025, merr këtë:


A K T G J Y K I M

Refuzohet e pathemeltë ankesa e parashtruar nga subjekti politik: Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZL.Anr.439/2025, të datës 14.11.2025.

A r s y e t i m

Me vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZL.Anr.439/2025, të datës 14.11.2025, është vendosur: Refuzohet e pabazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që të urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), që brenda afatit të caktuar ligjor, të përsërisë procesin zgjedhor në Komunën e Mitrovicës së Jugut, duke kryer rivotim në përputhje me ligjin dhe rregulloret përkatëse.

Kundër këtij vendimi ankesë në Gjykatën Supreme, ka parashtruar subjekti politik: Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, për shkak të: shkeljes së dispozitave të LZP-së, dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke i propozuar gjykatës që të: aprovoj të bazuar ankesën e ankuesit dhe të



prish vendimin e PZAP-it, ZL.Anr.439/2025, të datës 14.11.2025, dhe të urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, që brenda afatit të caktuar ligjor të përsërisë procesin zgjedhor në Komunën e Mitrovicës, duke kryer rivotim në përputhje me ligjin dhe rregulloret përkatëse.

PZAP, në përgjigje në ankesën e paraqitur kundër vendimit të atakuar, i konteston në tërësi thëniet ankimore dhe propozon që ankesa e parashtruar nga subjekti politik: Partia Demokratike e Kosovës (PDK), të refuzohet si e pabazuar, ndërsa vendimi i kontestuar i PZAP-it, ZL.Anr.439/2025, i datës 14.11.2025, të vërtetohet.

Gjykata Supreme e Kosovës, e vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se më datë 11.11.2025, PZAP-i ka pranuar ankesë nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë me të cilën thekson se me këtë ankesë paraqesim parregullsitë e konstatuara gjatë procesit të numërimit të fletëvotimeve në Komunën e Mitrovicës së Jugut, dhe se thelbi i kësaj ankese lidhet me faktin se fletëvotimet janë gjetur të përziera ndërmjet klasave dhe shkollave të ndryshme, pra nuk është respektuar përputhja me kodet unike të vendvotimeve. Kjo ka rezultuar në situata ku fletëvotimet e destinuara për një vendvotim janë gjetur në kutitë e një vendvotimi tjetër, brenda të njëjtës qendër votimi apo edhe në qendra të tjera votimi. Konkretisht, rastet e konstatuara janë: në vendvotimin 1103/04 është gjetur një fletëvotim i vendvotimit 1102/10; në vendvotimin 1102/11 është gjetur një fletëvotim i vendvotimit 1102/10 (gjithashtu, fletëvotimi është i vulosur dy herë, që tregon për “trenin bullgar”); në vendvotimin 1102/6 është gjetur një fletëvotim i vendvotimit 1102/05, fletëvotimi i Qendrës së Votimit 1102 të vendvotimit numër 5 (Shkolla “Abdullah Shabani”) është hasur në vendvotimin numër 6 të të njëjtës Qendër Votuese; fletëvotimi i Qendrës së Votimit 1102 të vendvotimit numër 1 (Shkolla “Abdullah Shabani”) është hasur në vendvotimin numër 4 të Qendrës Votuese 1103 (Universiteti “Isa Boletini”); fletëvotimi i vendvotimit numër 13 të Qendrës Votuese 1101 (Shkolla “Mixheni”) është hasur në kutinë e vendvotimit numër 5 të Qendrës Votuese 1102 (Shkolla “Abdullah Shabani”); fletëvotimi i Qendrës së Votimit 1102 të vendvotimit numër 1 (Shkolla “Abdullah Shabani”) është hasur në vendvotimin numër 5 të të njëjtës Qendër Votuese; fletëvotimi i Qendrës së Votimit 1102 të vendvotimit numër 4 (Shkolla “Abdullah Shabani”) është hasur në vendvotimin numër 5 të të njëjtës Qendër Votuese; fletëvotimi i vendvotimit numër 5 të



Qendrës së Votimit 1103 (Universiteti “Isa Boletini”) është hasur në kutinë e vendvotimit numër 1 të Qendrës së Votimit 1104 (Shkolla “Ismail Qemali”).

Tutje në ankesë theksohet se në këtë komunë, po ashtu, është vërejtur një fenomen i pazakonshëm dhe shqetësues: pjesëmarrja e votuesve në raundin e balotazhit ka rezultuar më e lartë se në raundin e parë, çka përbën rast unik në nivel të Kosovës dhe ngre dyshime serioze për manipulim elektoral dhe shtim artificial të votave. Gjithashtu, gjatë procesit të numërimit janë hasur shumë fletëvotime të pavulosura, ndërsa disa të tjera janë gjetur të vulosura dy herë, çka përforcon dyshimet për parregullsi të qëllimshme në procesin zgjedhor. Në ditën e votimit është ushtruar presion i papërshtatshëm mbi qytetarët e Mitrovicës; një qytetar madje është detyruar të mbyllë kafenenë e tij, gjë që ai vetë e ka dëshmuar publikisht në një deklaratë. Parashtruesi i ankesës thekson se këto parregullsi tregojnë qartë se procesi zgjedhor nuk ka qenë i lirë dhe i ndershëm, duke cenuar integritetin e votës dhe të drejtën e qytetarëve për të votuar në mënyrë të barabartë dhe të sigurt. Fakti që fletëvotimet janë manipuluar dhe disa janë gjetur të pavulosura ose të vulosura dy herë dëshmon për ndërhyrje të qëllimshme dhe për një mungesë të standardeve të domosdoshme për zgjedhje të lira dhe të ndershme.

Më tutje ka shtuar se fakti që ka mospërputhje mes kodit të fletëvotimit dhe vendvotimit përbën shkelje ligjore, pasi fletëvotimi duhet të ketë kodin e vet unik që duhet të përputhet me vendvotimin, siç parashikohet në nenin 87, paragrafi 5, nënparagrafi 5.5 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Aty thuhet: “Fletëvotimi duhet të përmbajë tiparet e sigurisë, sikurse janë përcaktuar nga KQZ-ja”. Me qëllim që kjo kërkesë e ligjit për sigurinë e fletëvotimeve të operacionalizohet, është nxjerrë Rregullorja Zgjedhore nr. 10/2024 për fletëvotimin dhe broshurën e KQZ-së. Në nenin 5, paragrafi 5 përcaktohet: “Fletëvotimet kanë numrin serik, që shtypet në anën e sipërme të djathtë të pjesës amë, e cila mbetet pas shpërndarjes së fletëvotimit. Numri serik është tetëshifror dhe fillon nga 01000000.” Ndërsa paragrafi 6 përcakton i po kësaj rregullore: “Në fletëvotim shtypet kodi i vendvotimit (VV), që është kombinim i shkronjave dhe numrave që lidhen me fletëvotimin. Ky kod shënohet në pjesën e sipërme dhe të pasme të fletëvotimit.”

Po ashtu, kjo bie ndesh edhe me Manualin për Procedurat e Votimit dhe Numërimit në Vendvotime, raundi i dytë, të KQZ-së. Pika 10 (10.22) përcakton se: “Fletëvotimi konsiderohet i vlefshëm nëse ka numrin serik dhe VV përkatës.” E gjithë kjo është e paligjshme dhe me këtë është cenuar integriteti i procesit zgjedhor, të cilin e mbrojnë Ligji Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e



Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Në nenin 59, paragrafi 4, nënparagrafi 4.45 përcakton: “Gjatë zbatimit të mandatit të vet, KQZ-ja, inter alia, (...) kryen çdo funksion tjetër ndihmës për mbajtjen e zgjedhjeve në Kosovë që i përcaktohet me rregulloret relevante dhe instrumentet ndihmëse, përfshirë veprimet e domosdoshme për mbrojtjen e integritetit të procesit zgjedhor në rast shfaqjeje të një force madhore.” Pala ankuese po ashtu thekson se në përgjigje të KQZ-së, e cila ka theksuar se gjatë shtypjes së fletëvotimeve është bërë një gabim teknik. Por edhe nëse kjo është e vërtetë, ajo nuk e shmang nevojën për rivotim dhe përsëritje të zgjedhjeve në Mitrovicë. Vetëm në këtë mënyrë mund të sigurohet që procesi zgjedhor të zhvillohet sipas ligjit, me fletëvotime të sigurta dhe të vlefshme. Shkeljet e konstatuara - përzjerja e fletëvotimeve ndërmjet shkollave dhe klasave të ndryshme, mospërputhja me kodet unike të vendvotimeve, prania e fletëvotimeve të pavulosura ose të vulosura dy herë - janë sistematike dhe jo rastësore. Rezultatet e vetëm disa vendvotimeve nuk mund të pasqyrojnë vullnetin real të qytetarëve, dhe një rivotim i pjesshëm nuk garanton një proces zgjedhor të lirë, të ndershëm dhe të sigurt. Pala ankuese ka bashkangjitur një CD me parregullsitë e pretenduara, librin e evidencës në QKN me shënimet nga kryesuesi dhe anëtarët e QKN-së, fletëvotime.

Në përgjigjen në ankesë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), thekson se, pas shqyrtimit të ankesës dhe pretendimeve të palës ankuese në lidhje me pretendimin ankimor për shkeljet ligjore të nenit 87 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 87 (Përshkrimi i fletëvotimit dhe materialit në lidhje me fletëvotimin), paragrafi 5 - KQZ, më datë 08.03.2024, ka miratuar Rregulloren Zgjedhore Nr. 10/2024 për Fletëvotimet dhe Broshurat. Më pas, më datë 27.05.2025, është miratuar Rregullorja Zgjedhore Nr. 01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Zgjedhore Nr. 10/2024 për Fletëvotimet dhe Broshurat. Neni 5 (Detajet teknike të fletëvotimeve dhe broshurave) i rregullores përcakton detajet teknike të fletëvotimeve dhe broshurave, si dhe paragrafi 5 dhe 6 thotë: “5. Fletëvotimet kanë numrin serik, që shtypet në anën e sipërme të djathtë të pjesës amë, e cila mbetet pas shkëputjes së fletëvotimeve. Numri serik është tetëshifror dhe fillon nga 01000000. 6. Në fletëvotim shtypet kodi i vendvotimit (VV), që është kombinim i shkronjave dhe numrave, e që ndërlidh fletëvotimin me VV. Ky kod shënohet në pjesën e përparme të fletëvotimit.”

Tutje ka theksuar se ZEKK në Mitrovicën e Jugut ka raportuar përmes emailit më datë 09.11.2025 lidhur me evidentimin e një fletëvotimi me kod 1110/02 në vendvotimin 1110/03, gjatë numërimit në vendvotim. Po ashtu, pas fillimit të verifikimit në QKN, më datë 10.11.2025, nga ZEKK në Mitrovicën e Jugut janë njoftuar se Prokuroria Themelore në



Mitrovicën e Jugut ka lëshuar urdhëresë për ndërprerjen e verifikimit të votave në QKN, deri në pranimin të sqarimit nga operatori ekonomik "Cetis". Ndërsa më datë 11.11.2025, KQZ ka pranuar sqarimin nga kompania Cetis, në të cilin thuhet se pas pranimin të fotografive që tregonin gabimin, kompania ka zhvilluar një hetim të plotë të procesit të prodhimit dhe përgatitjes së të dhënave. Hetimi ka zbuluar se problemi ka ndodhur vetëm në një nga katër kokat e printerit që shtyp kodin e vendvotimit. Për shkak se sistemi i kontrollit monitoron vetëm numrin serik (QR-kodin), ky gabim nuk është detektuar gjatë procesit të shtypjes. Më tej, Cetis thekson se merr plotësisht përgjegjësinë për këtë gabim teknik, duke nënvizuar se fletëvotimet përmbajnë elemente të shumta sigurie që e bëjnë të pamundur falsifikimin apo kopjimin e tyre.

Përmes përgjigjes në ankesë KQZ ka deklaruar se më datë 12.11.2025 ka themeluar komisionin prej 8 zyrtarëve të Sekretariatit të KQZ-së për vlerësimin e fletëvotimeve dhe përputhjes së numrit të fletëvotimeve në vendvotime për zgjedhjet për raundin e dytë Kryetar Komune, me qëllim të evidentimit të çështjeve të raportuara nga KKZ në Mitrovicën e Jugut dhe në funksion të përgjigjes për PZAP lidhur me këtë ankesë. Komisioni ka nisur punën më 12.11.2025, ndërsa në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve ka vazhduar aktivitetet më 13.11.2025, duke hapur dhe shqyrtuar gjithsej 105 kuti të votimit nga vendvotimet e rregullta të komunës së Mitrovicës së Jugut. Gjatë procesit të vlerësimit, komisioni ka bërë hapjen dhe verifikimin e të gjitha kutive të votimit, duke numëruar dhe analizuar fletëvotimet e papërdorura dhe ato të përdorura, si dhe duke evidentuar fletëvotimet me gabime në shtypje. Është bërë kontrolli i origjinalitetit të fletëvotimeve të përdorura përmes pajisjeve përkatëse, si dhe është kryer shqyrtimi i statistikave të secilit vendvotim.

Sipas raportit të komisionit, si rezultat i procesit të verifikimit, komisioni ka ardhur në përfundimet si vijon: vendvotimet në të cilat është konstatuar shtypja e kodit të gabuar të vendvotimit në fletëvotime janë: 1101/01, 1101/02, 1101/03, 1101/04, 1101/06, 1101/07, 1101/08, 1101/09, 1101/11, 1101/12, 1101/13, 1102/01, 1102/03, 1102/04, 1102/05, 1102/06, 1102/08, 1102/09, 1102/10, 1102/11, 1103/03, 1103/04, 1103/05, 1104/01, 1104/04, 1104/05, 1104/06, 1105/02, 1105/03, 1105/04, 1105/05, 1106/03, 1106/04, 1106/05, 1107/02, 1107/03, 1107/04, 1108/01, 1109/02, 1109/03, 1109/04, 1109/05, 1110/01, 1110/02, 1110/03, 1110/04, 1110/07, 1111/01, 1111/02, 1111/05, 1111/06, 1112/01, 1113/01, 1114/01, 1115/01, 1116/01, 1116/02, 1116/05, 1117/01, 1118/01, 1118/02, 1120/01, 1120/02, 1121/01, 1122/01, 1122/02, 1124/02, 1125/01, 1126/01, 1127/01, 1128/01, 1129/01, 1129/02, 1130/01.



Nga verifikimi rezulton se gjithsej 124 fletëvotime nuk kanë kodin përkatës të vendvotimit, pra kodi është shtypur gabim. Nga këto, 116 fletëvotime e kanë të shtypur kodin e një vendvotimi tjetër, ndërsa 8 fletëvotime nuk kanë të shtypur fare kod të vendvotimit. Tek fletëvotimet e papërdorura janë identifikuar 84 dengje (batch-e) në të cilat janë evidentuar fletëvotime të shtypura me kod të gabuar (76 fletëvotime) dhe pa kod (8 fletëvotime). Në të gjitha këto raste, gabimi paraqitet tek fletëvotimi i fundit i dengut. Ndërsa tek fletëvotimet e përdorura janë identifikuar 40 fletëvotime të cilat kanë kodin e vendvotimit tjetër. Prej tyre, në 18 fletëvotime është votuar për kandidatin me numër 105, Faton Peci - Lëvizja Vetëvendosje, ndërsa në 22 fletëvotime është votuar për kandidatin me numër 191, Arian Tahiri - Partia Demokratike e Kosovës (PDK). Numri i fletëvotimeve të shtypura për 105 vendvotimet në 32 qendrat e votimit të rregullta është 72 750, ashtu sikurse është përcaktuar me vendimin e KQZ-së. Kjo sasi është pranuar nga KKZ, dhe secili nga 105 Këshillat e Vendvotimeve ka pranuar sasinë sikurse është përcaktuar nga KQZ dhe shtypur nga kontraktori.


Përmes përgjigjes në ankesë KQZ-ja ka theksuar se raporti i pranuar nga Cetis më 11.11.2025, pas auditimit të pajisjeve, në të cilin janë identifikuar 74 vendvotime ku mund të jenë paraqitur gabimet, numrat serikë të dengjeve përkatëse dhe lloji i gabimit për secilin rast (kod i vendvotimit i shtypur gabim ose i lënë zbrazët), përputhet plotësisht me gjetjet si rezultat i verifikimit të bërë nga komisioni më datë 13.11.2025 në QNR, pas hapjes së 105 kutive të votimit në vendvotimet e Mitrovicës së Jugut. Në të gjitha vendvotimet numri i fletëvotimeve të vlefshme, të pavlefshme dhe të dëmtuara përputhet me numrin e fletëvotimeve të pranuar nga Këshilli i Vendvotimit. Numrat serikë të dengjeve (amave) të fletëvotimeve përputhen me numrat serikë të pranuar dhe të destinuar për secilin vendvotim. Në asnjë vendvotim nuk është gjetur ndonjë fletëvotim tjetër përveç atyre të shtypura nga KQZ (origjinale), bazuar në librat e votimit të evidentuar nga Këshillat e Vendvotimeve, librat e evidencës së Ekipeve të Numërimit, raportit të KKZ-së dhe verifikimeve të bëra nga komisioni. Andaj, KQZ sqaron se, në kontekstin e elementeve të sigurisë, kodi i vendvotimit nuk përbën element sigurie të fletëvotimit, sipas përcaktimeve të nenit 5, paragrafi 3, të Rregullores Zgjedhore Nr. 10/2024 për Fletëvotimet dhe Broshurat, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Zgjedhore Nr. 01/2025. Ashtu siç është sqaruar më sipër, KQZ sqaron se gabimi i evidentuar është ekskluzivisht teknik dhe i kufizuar në shtypjen e kodit të vendvotimit në disa fletëvotime të fundit brenda disa dengjeve, përfshirë edhe ato të përdorura, në të cilat janë evidentuar preferencat e votuesve për të dy kandidatët. Asnjë nga fletëvotimet e dedikuara për vendvotim nuk janë bartur në vendvotime tjera, por që për shkak të gabimeve në printim, siç e kemi



shpjeguar më lart, kanë qenë pjesë e dengjeve. Për të ekzistuar i ashtuquajtur "tren bullgar", do të duhej që ndonjë fletëvotim të mungojë apo të gjendet ndonjë fletëvotim i falsifikuar, çka në rastin konkret nuk ka ndodhur, të gjitha fletëvotimet janë origjinale të vendvotimeve dhe përmbajnë të gjitha elementet e sigurisë të përcaktuara me rregulloren e KQZ. Gabimet e evidentuara nuk kanë ndikuar në asnjë mënyrë në integritetin e procesit të votimit dhe as në rezultatin zgjedhor, sepse votuesve iu është dhënë fletëvotimi të cilën e kanë plotësuar duke e shprehur vullnetin e tyre dhe duke e futur në kutinë e votimit. Si provë ka bashkangjitur përgjigjen e Operatorit Ekonomik CETIS të datës 11.11.2025, si dhe një raport të pranuar nga CETIS me gabimet e evidentuara pas auditimit që e kanë bërë në pajisjet (sistemin e printimit) me datë 12.11.2025.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, me vendimin ZL.Anr.439/2025, të datës 14.11.2025, ka refuzuar të pabazuar ankesën e parashtruar nga subjekti politik: Partia Demokratike e Kosovës (PDK).

PZAP, në arsyetim të vendimit të tij ndër të tjera ka theksuar se: Pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore dhe përgjigjes në ankesë të KQZ-së, Paneli vlerësoi se pretendimet në ankesën e parashtruar nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me të cilën pretendohet se fletëvotimet e destinuara për një vendvotim janë gjetur në kutitë e një vendvotimi tjetër, brenda të njëjtës qendër votimi apo edhe në qendra të tjera votimi, pra nuk është respektuar përputhja me kodet unike të vendvotimeve, konkretisht, rastet si: në vendvotimin 1103/04 është gjetur një fletëvotim i vendvotimit 1102/10; në vendvotimin 1102/11 është gjetur një fletëvotim i vendvotimit 1102/10 (gjithashtu, fletëvotimi është i vulosur dy herë, që tregon për "trenin bullgar"); në vendvotimin 1102/6 është gjetur një fletëvotim i vendvotimit 1102/05, fletëvotimi i Qendrës së Votimit 1102 të vendvotimit numër 5 (Shkolla "Abdullah Shabani") është hasur në vendvotimin numër 6 të të njëjtës Qendër Votuese; fletëvotimi i Qendrës së Votimit 1102 të vendvotimit numër 1 (Shkolla "Abdullah Shabani") është hasur në vendvotimin numër 4 të Qendrës Votuese 1103 (Universiteti "Isa Boletini"); fletëvotimi i vendvotimit numër 13 të Qendrës Votuese 1101 (Shkolla "Migjeni") është hasur në kutinë e vendvotimit numër 5 të Qendrës Votuese 1102 (Shkolla "Abdullah Shabani"); fletëvotimi i Qendrës së Votimit 1102 të vendvotimit numër 1 (Shkolla "Abdullah Shabani") është hasur në vendvotimin numër 5 të të njëjtës Qendër Votuese; fletëvotimi i Qendrës së Votimit 1102 të vendvotimit numër 4 (Shkolla "Abdullah Shabani") është hasur në vendvotimin numër 5 të të njëjtës Qendër



Votuese; fletëvotimi i vendvotimit numër 5 të Qendrës së Votimit 1103 (Universiteti "Isa Boletini") është hasur në kutinë e vendvotimit numër 1 të Qendrës së Votimit 1104 (Shkolla "Ismail Qemali"). Gjithashtu edhe pretendimet e ankuesit lidhur me nenin 59 dhe 87, paragrafi 5, nënparagrafi 5.5. të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe pretendimet tjera të përshkruara në ankesë, janë të pabazuara.

Paneli, në bazë të provave të prezantuara nga pala ankuese, përgjigjet në ankesë nga KQZ, dhe raportit nga kompania Cetus, vlerëson se pretendimet ankimore janë të paqëndrueshme për arsye se ankuesi nuk ka prezantuar prova për të dëshmuar këto parregullsi, ndërsa nga përgjigja e KQZ-së rezulton se ky institucion, për të vlerësuar parregullsitë e pretenduara, ka themeluar Komision të veçantë, ku pas vlerësimit dhe verifikimit, nga hapja dhe shqyrtimi i 105 kutive të votimit nga vendvotimet në këtë komunë dhe pas numërimit dhe analizimit të fletëvotimeve të papërdorura dhe ato të përdorura, si dhe duke evidentuar fletëvotimet me gabime, është nxjerrë përfundimi se në gjithsej 124 fletëvotime nuk kanë kodin përkatës të vendvotimit, përkatësisht kodi është shtypur gabim; nga këto, 116 fletëvotime e kanë të shtypur kodin e një vendvotimi tjetër, ndërsa 8 fletëvotime nuk kanë të shtypur fare kodin e vendvotimit. Nga këto fletëvotime, 40 janë përdorur e të cilat e kanë kodin e fletëvotimit tjetër, prej këtyre 40 fletëvotimeve, 18 prej tyre i përkasin kandidatit nr. 105, Faton Peci - Lëvizja Vetëvendosje, ndërsa 22 fletëvotime është votuar për kandidatin me numër 191, Arian Tahiri - Partia Demokratike e Kosovës (PDK). Përveç kësaj, nga hetimi i bërë nga KQZ-ja ka rezultuar se në të gjitha vendvotimet numri i fletëvotimeve të vlefshme, të pavlefshme dhe të dëmtuara përputhet me numrin e fletëvotimeve të pranuar nga Këshilli i Vendvotimit. Numrat serikë të dengjeve (amave) të fletëvotimit përputhen me numrat serikë të pranuar dhe të destinuara për secilin vendvotim. Në asnjë vendvotim nuk është gjetur ndonjë fletëvotim tjetër përveç atyre të shtypura nga KQZ (origjinale), bazuar në librat e votimit të evidentuar nga Këshillat e Vendvotimeve, librat e evidencës së Ekipeve të Numërimit, Raportit të KKZ-së dhe verifikimeve të bëra nga Komisioni.

Paneli vlerëson si të pabazuar pretendimin e ankuesit lidhur me shkeljet e nenit 87 parag. 5 nënparag. 5 të LZP-së, e që ka të bëjë me fletëvotimet, përkatësisht tiparet e sigurisë; kjo pasi që fletëvotimi i përmban tri veçori të sigurisë: mikroshtypi, UV print, anticopy, të cilat janë përcaktuar me nenin 5 të Rregullores Zgjedhore 10/2024 dhe plotësim-ndryshimin e kësaj Rregulloreje 01/2025. Këto tipare të sigurisë i ka përcaktuar KQZ me akte nënligjore, të cilat burojnë nga neni 87 paraagraf 5 i LZP-së. Nga kjo rezulton se kodi i vendvotimit nuk përbën



element sigurie të fletëvotimit, kjo pasi që numri serik i fletëvotimeve ka qenë në rregull dhe i saktë, por që gabimi teknik ka ndodhur me kodin e vendvotimit. Andaj, nga kjo dhe sqarimi i dhënë nga kompania CETIS më datë 11.11.2025, rezulton se gabimi është vetëm teknik, ndërsa fletëvotimet përmbajnë elemente të shumta të sigurisë që e bëjnë të pamundur falsifikimin apo kopjimin e tyre, duke sqaruar se problemi ka ndodhur vetëm në një nga katër kokat e printerit që shtyp kodin e vendvotimit.

Paneli vlerëson se në këtë rast nuk është cenuar integriteti i zgjedhjeve, kjo pasi që nga provat ekzistuese rezulton se ka ekzistuar vetëm gabim teknik në kodin e fletëvotimit në vendvotim, ndërsa numri serik dhe elementet e tjera që kanë qenë të domosdoshme për sigurinë e fletëvotimit kanë ekzistuar në secilin fletëvotim, ashtu siç është përcaktuar edhe me Rregulloren Zgjedhore të KQZ-së 10/2024 Fletëvotimet dhe Broshurat dhe plotësim-ndryshimin e kësaj Rregulloreje me Rregulloren nr. 01/2025.

Sa i përket pretendimeve të palës ankuese për dërgimin në rivotim dhe përsëritjen e zgjedhjeve në gjithë territorin e Mitrovicës së Jugut, Paneli vlerëson se ky pretendim është i pathemeltë, pasi që në rastin konkret përmes provave të administruara nuk është arritur të provohet se ka shkelje të Ligjit të Zgjedhjeve apo të Rregullave të KQZ-së, me të cilat është cenuar integriteti i zgjedhjeve apo të ketë ndikuar në rezultatin zgjedhor për Kryetar të Komunës së Mitrovicës së Jugut. Paneli vlerëson se është i pabazuar pretendimi ankimor për bartjen e votave nga një qendër në qendër tjetër, për arsye se e gjithë kjo ka ndodhur për shkak të gabimit teknik në kodin e fletëvotimit, pasi që është konstatuar se nuk ka pasur fletëvotime tjera përveç atyre të shtypura, sepse numri i fletëvotimeve të shtypura për 105 vendvotime në 32 qendrat e votimit të rregullta ka qenë 72 750 fletëvotime, e cila sasi është pranuar nga Këshillat e vendvotimeve sipas vendimit të KQZ-së, e që nënkupton se nuk ka pasur më tepër fletëvotime se ato të cilat i ka shtypur kontraktori - kompania Cetis.

Lidhur me pretendimin për të ashtuquajturin "Trenin Bullgar", Paneli vlerëson se nuk qëndron një pretendim i tillë, për faktin se me asnjë provë nuk është vërtetuar se në rastin konkret të ketë mungesë të ndonjë fletëvotimi apo të ketë ndonjë fletëvotim të falsifikuar, ndërsa në anën tjetër është vërtetuar se të gjitha fletëvotimet janë origjinale dhe të njëjtat i përmbajnë të gjitha elementet e sigurisë të përcaktuara sipas Rregullave të KQZ-së. Po ashtu, Paneli vlerëson se në të gjitha vendvotimet numri i fletëvotimeve të vlefshme dhe të pavlefshme si dhe atyre të dëmtuara përputhet me numrin e pranuar nga Këshilli i vendvotimit, si dhe numrat serik të



dengjeve të fletëvotimit përputhen me numrat serik të pranuar dhe destinuar për secilin vendvotim. Gjithashtu në asnjë vendvotim ku janë hasur fletëvotime me gabime teknike nuk është gjetur asnjë fletëvotim tjetër përveç atyre të shtypura nga ana e KQZ-së, andaj pretendimet e subjektit ankues në këtë drejtim janë vlerësuar të pabazuara.

Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, Paneli vendosi që të refuzojë si të pabazuar ankesën e ankuesit, për arsye se ankuesi nuk ka dëshmuar me prova konkrete pretendimet e ngritura në ankesën për rivotim, ndërsa me provat e prezantuara nuk ka arritur të përmbushë standardin e kërkuar ligjor për të konstatuar se ka pasur cenim të procesit zgjedhor e i cili do të kishte ndikim në rezultatin për raundin e dytë të zgjedhjeve lokale për Kryetar të Komunës së Mitrovicës së Jugut. Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës, në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nen në mënyrë decitive thuhet se *"Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse"*. Nga arsyet e theksuara më lart dhe duke u bazuar në nenin 117 paragrafi 3, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, paneli vendosi si në dispozitiv të vendimit të tij.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë faktike dhe ligjore e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të bazuar qëndrimin juridik të PZAP-it, si në vendimin e tij, me të cilin e ka refuzuar të pabazuar ankesën e subjektit politik: Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për shkak të parregullsive të pretenduara gjatë procesit zgjedhor në Komunën e Mitrovicës së Jugut, për Zgjedhjet Lokale për Kryetar të Komunave, në Raundin e Dytë, që janë mbajtur më datë 09 nëntor 2025. Vendimi i PZAP është i drejtë i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare nga vërtetohet se edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë në kuptim të dispozitave ligjore të Ligjit Nr. 03/L-072 Për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, si dhe të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, të cilat mutatis mutandis vlejnë edhe për zgjedhjet lokale përveç nëse përcaktohet ndryshe me anë të këtij ligji.

Objekt shqyrtimi dhe vlerësimi në Gjykatën Supreme të Kosovës ishin pretendimet e subjektit politik ankues, përkitazi me parregullsitë e pretenduara gjatë procesit zgjedhor në Komunën e Mitrovicës së Jugut, të cilat, sipas ankuesit, kanë cenuar integritetin e votës dhe ligjshmërinë e procesit, ku ndër të tjera theksi i pretendimeve të tij vihet në: mospërputhjen e kodeve të



fletëvotimeve me vendvotimet përkatëse në një numër të konsiderueshëm vendvotimesh, gjetjen e fletëvotimeve të pavulosura dhe të vulosura dy herë, përzierjen e fletëvotimeve ndërmjet shkollave, klasave dhe qendrave të ndryshme të votimit, pjesëmarrje e votuesve në raundin e balotazhit më e lartë se në raundin e parë, çka ngre dyshime për manipulim elektoral dhe shtim artificial të votave, dyshimet për ekzistimin e metodave të manipulimit të tipit “treni bullgar”, si dhe pretendimet se PZAP-i nuk ka kryer hetim të pavarur dhe të drejtpërdrejtë të fletëvotimeve në QNR, duke u mbështetur vetëm në raportin e një komisioni të ngritur nga vetë KQZ-ja, çka, sipas tij, cenon parimin e paanshmërisë dhe të drejtën për një procedurë të rregullt.

Gjykata, me qëllim të shqyrtimit të drejtë dhe të saktë të pretendimeve të subjektit politik ankues, përkatësisht vlerësimit nëse këto pretendime paraqesin shkelje të natyrës substanciale, të cilat mund të kenë ndikuar në integritetin e zgjedhjeve dhe në rezultatin përfundimtar, ju referua dispozitave ligjore vijuese:

Ligji nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës,

Neni 87 [Përshkrimi i Fletëvotimit dhe materialit në lidhje me Fletëvotimin], “1. Emri i subjektit politik dhe kandidatëve të tyre paraqiten në fletëvotim siç paraqiten në origjinalin e aplikimit për certifikim, subjekt i modifikimeve nëse ka dhe në fund të miratuara nga KQZ-ja. 2. Votuesi udhëzohet për të shënuar zgjedhjen e tij/saj aq qartë që të mos ketë paqartësi mbi preferencat. 3. Emrat e të gjithë kandidatëve në materialin e shtypur të ekspozuara në vendvotime ose Qendra të Votimeve shfaqen drejtpërdrejt nën emrin e partisë politike, koalicionit ose nismës qytetare që ka dorëzuar listën e kandidatëve. 4. KQZ-ja përcakton numrin e fletëvotimeve të cilat shtypen dhe shpërndahen. Numri i fletëvotimeve nuk tejkalon për më shumë se pesë për qind (5 %) numrin e votuesve në listën e votuesve. 5. Fletëvotimi duhet të përmbajë: 5.1. treguesin e qarkut elektoral; 5.2. organin publik që do të zgjidhet; 5.3. numrin rendor të vendosur para secilit subjekt politik individual zgjedhor; 5.4. emrin dhe akronimin e secilit subjekt politik sipas radhës së përcaktuar me shortin për fletëvotim; 5.5. tiparet e sigurisë, sikurse janë përcaktuar nga KQZ-ja; 5.6. çfarëdo informate tjetër të kërkuar me këtë ligj dhe me rregullat e miratuara në përputhje me të. 6. KQZ-ja më tutje përcakton me anë të rregullores detajet e fletëvotimeve, duke përfshirë: 6.1. përmbajtjen; 6.2. formatin dhe ekspozimin/dukjen; 6.3. mënyrën dhe kontrollin e printimit; 6.4. verifikimin, shpërndarjen dhe



trajtimin e fletëve të votimit; 6.5. veçoritë e sigurisë; dhe 6.6. çfarëdo çështje tjetër lidhur me procesin. 7. Fletëvotimet shtypen nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejt të KQZ-së.”

Rregullore Zgjedhore Nr. 10/2024 Fletëvotimet dhe Broshurat

Neni 5 [Detajet teknike të fletëvotimeve dhe broshurave], “3. Fletëvotimet përmbajnë së paku tri veçori të sigurisë, që i bëjnë të mbrojtura nga kopjimi apo falsifikimi. Veçoritë e sigurisë janë: 3.1. Mikroshtypi - ku shtypen karaktere apo një mostër e caktuar në një madhësi të vogël, e padukshme për sy, ku duhet të përdoret një zmadhues për t’u parë; 3.2. UV Print - një dizajn unik vendoset në pjesën e përparme të fletëvotimit, që mund të shihet vetëm përmes UV-llambës; 3.3. Anticopy - mbrojtje nga kopjimi - si element i cili mbron fletëvotimin nga kopjimi. Ky element vendoset në pjesën e përparme të fletëvotimit dhe në momentin që një fletëvotim kopjohet, shfaqet shenja dalluese se ai është i kopjuar; 3.4. Fletëvotimet kanë një shenjë të veçantë dalluese që propozohet nga operatori, i cili bën shtypjen e fletëvotimeve dhe është unik për nga mënyra e krijimit dhe identifikimit të tij.”

Rregullore Zgjedhore Nr. 01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Zgjedhore Nr.10/2024 Fletëvotimet dhe Broshurat

Neni 2:

Paragrafi 5 i nenit 5 të Rregullores bazike ndryshohet si në vijim: “Fletëvotimet kanë një numër serik, i cili është i shtypur në anën e sipërme të djathtë të pjesës amë që mbetet pas shpërndarjes së fletëvotimeve.”

Paragrafi 6 i nenit 5 Rregullores bazike ndryshohet si në vijim: “Fjala “dhe të pasme” fshihet.”

Pas paragrafit 7 të nenit 5 të Rregullores bazike, shtohet një paragrafi me tekstin si në vijim : “Në anën e pasme të fletëvotimit, në pjesën e sipërme, në mes, vendoset një kornizë me formë të rrumbullakët për vulosjen e fletëvotimit, së bashku me përshkrimin “Vulos”.

Në kuptim të dispozitave të lartcekura, dhe sipas vlerësimit të kolegjit të Gjykatës Supreme të Kosovës, përcaktuese për ligjshmërinë e vendimit të PZAP është fakti se të gjitha procedurat e përgatitjes, shtypjes dhe shpërndarjes së fletëvotimeve janë kryer në përputhje me Ligjin nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe me Rregulloren Zgjedhore Nr. 10/2024 për Fletëvotimet dhe Broshurat dhe Rregulloren për Ndryshim-Plotësim Nr. 01/2025, duke përfshirë: përputhshmërinë e përmbajtjes së fletëvotimeve me listat e certifikuara të



kandidatëve dhe partive politike, zbatimin e veçorive të sigurisë që parandalojnë kopjimin dhe falsifikimin e fletëvotimeve, përfshirë mikroshtypin, UV Print, elementin anticopy dhe numrin serik, mbikëqyrjen e plotë nga KQZ-ja gjatë shtypjes, verifikimit, shpërndarjes dhe trajtimit të fletëvotimeve.

Nga shkresat e lëndës shihet se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më datë 12.11.2025, ka themeluar Komisionin për vlerësimin e fletëvotimeve dhe përputhjes së numrit të fletëvotimeve në vendvotime, i cili komision ka hapur dhe ka shqyrtuar 105 (njëqind e pesë) kuti të votimit nga vendvotimet e rregullta të Komunës së Mitrovicës së Jugut. Gjatë procesit të vlerësimit, komisioni ka bërë hapjen dhe verifikimin e të gjitha kutive të votimit, duke numëruar dhe analizuar fletëvotimet e përdorura dhe ato të përdorura si dhe duke evidentuar fletëvotimet me gabime në shtypje, po ashtu është bërë edhe kontrolli i origjinalitetit të fletëvotimeve të përdorura përmes pajisjeve përkatëse, si dhe është kryer shqyrtimi i statistikave të secilit vendvotim.

Nga verifikimi i komisionit rezulton se gjithsej 124 (njëqind e njëzetekatër) fletëvotime nuk kanë kodin përkatës të vendvotimit, prej të cilave 116 (njëqind e gjashtëmbëdhjetë) është shtypur kodi i një vendvotimi tjetër ndërsa 8 (tetë) prej tyre nuk kanë të shtypur kod të vendvotimit fare. Nga numri total i fletëvotime të përdorura janë identifikuar vetëm 40 (katër dhjetë) fletëvotime të cilat kanë kodin e vendvotimit tjetër. Nga këto 40 (katër dhjetë) fletëvotime në 18 (tetëmbëdhjetë) prej tyre është votuar për kandidatin me numër 105 - Faton Peci, nga Lëvizja VETËVENDOSJE!, ndërsa në 22 (njëzetedy) fletëvotime është votuar për kandidatin 119 - Arian Tahiri nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK).

Po ashtu, rezulton se numri i fletëvotimeve të shtypura për 105 vendvotime është i njëjtë ashtu siç është përcaktuar nga KQZ, me gjithsej 72,750 fletëvotime. Në bazë të verifikimit është gjetur se bazuar në Librat e votimit të evidentuar në Këshillat e Vendvotimeve, librat e evidencës së Ekipeve të Numërimit, dhe Raportit të KKZ-së rezulton se në asnjë vendvotim nuk është gjetur ndonjë fletëvotim tjetër përveç atyre origjinaleve të shtypura nga KQZ.

Nga provat e parashtruara në procedurë para PZAP-it dhe në procedurën e shqyrtimit gjyqësor, Gjykata konstaton se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që vërtetojnë shkelje të dispozitave të përmendura. Në veçanti, nuk është faktuar se fletëvotimet e përdorura kanë qenë pa tipare sigurie, pa numër serik, pa vulë, apo të shtypura në kundërshtim me rregullat teknike të



përcaktuara nga KQZ-ja. Po ashtu, nuk është dëshmuar se përzierja e supozuar e fletëvotimeve ndërmjet vendvotimeve ka ndikuar në rezultatin përfundimtar, as në aspekt cilësor, as në atë sasior.

Parashtruesi i ankesës pretendon se fletëvotimet e destinuara për një vendvotim janë gjetur në vendvotime të tjera, çka sipas tij përbën “tren bullgar” dhe cenon integritetin e votimit. Megjithatë, nga verifikimet e kryera në vendvotime, rezulton se të gjitha fletëvotimet janë origjinale dhe përmbajnë tri elementet e sigurisë të përcaktuara në nenin 87 paragrafi 5 nën paragraf 5.5 të LZP-së, numrat serikë të fletëvotimeve dhe të dengjeve të cilat përputhen plotësisht me numrat e pranuar nga Këshillat e Vendvotimeve, asnjë fletëvotim i falsifikuar, i shtuar apo i munguar nuk është identifikuar nga PZAP apo nga auditimi teknik i kryer nga kompania CETIS dhe parregullsia konsiston vetëm në shtypjen e gabuar të kodit të vendvotimit, e cila sipas raportit teknik të CETIS-it është rezultat i një defekti të pajisjes së printimit.

Gjykata vlerëson se kodi i vendvotimit nuk përbën element sigurie, pasi tiparet e sigurisë së fletëvotimit përcaktohen me akte nënligjore të KQZ-së dhe nuk përfshijnë kodin e vendvotimit. Për rrjedhojë, defekti i identifikuar nuk cenon vlefshmërinë e fletëvotimit. Sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj Gjykate, një proces zgjedhor mund të cenohet vetëm nëse parregullsia: ndikon realisht në shprehjen e vullnetit të votuesve, dhe ka potencial objektiv të ndryshojë rezultatin zgjedhor. Ngase, në rastin konkret parregullsia është identifikuar vetëm në 124 fletëvotime, nga të cilat 40 fletëvotime janë përdorur. Nga këto 40 fletëvotime, votat janë ndarë ndërmjet dy kandidatëve (22 për njërin dhe 18 për tjetrin), pa treguar prirje që favorizon ndonjërin prej tyre. Pastaj, numri i fletëvotimeve të vlefshme, të pavlefshme dhe të dëmtuara përputhet plotësisht me numrin e fletëvotimeve të pranuar në çdo vendvotim dhe asnjë disproporcion apo mospërputhje numerike nuk është evidentuar. Këto rrethana tregojnë se gabimi teknik nuk ka ndikuar dhe nuk ka pasur ndikim relevant në rezultatin e zgjedhjeve.

Parashtruesi i ankesës po ashtu pretendon se fletëvotimi konsiderohet i vlefshëm vetëm nëse ka numrin serik dhe VV përkatës, siç përcaktohet në Manualin për Procedurat e Votimit dhe Numërimit në Vendvotim, përkatësisht në pikën 10.2.2, megjithatë kolegji i kësaj gjykate vlerëson se edhe sikur një pretendim i tillë të qëndronte numri i fletëvotimeve të cilat janë ndarë ndërmjet dy kandidatëve nuk do të ndryshonte rezultatin e zgjedhjeve, andaj të njëjtin e vlerësoj pa ndikim në rastin konkret.



Pretendimi se pjesëmarrja më e lartë e votuesve në raundin e balotazhit krahasuar me raundin e parë tregon manipulim elektoral dhe shtim artificial të votave nuk qëndron, pasi pjesëmarrja në zgjedhje është në vullnet të lirë të qytetarëve. Diferencat në numrin e votuesve mund të shpjegohen me motivimin më të madh për të marrë pjesë në balotazh, mobilizimin e komuniteteve, ndryshimet demografike dhe lëvizjet normale të votuesve. Nuk është evidentuar asnjë provë që të tregojë shtim të paligjshëm të votave apo manipulim të procesit zgjedhor. Po ashtu, as pretendimi se është ushtruar presion mbi votuesit nuk mbështetet nga asnjë provë konkrete me rendësi juridike.

Ankuesi në ankesë i referohet praktikës së kthimit të çështjeve në rivotim nga ana e PZAP dhe të Gjykatës Supreme, duke theksuar se raste të natyrës më të lehtë kanë rezultuar në rivotim, përkritazi me këtë pretendim Gjykata, vlerëson se praktika e mëparshme duhet të merret parasysh, por çdo rast kërkon vlerësim të veçantë në raport me natyrën, shkallën dhe ndikimin e parregullsive të pretenduara.

Gjykata Supreme konstaton se asnjë nga pretendimet e palëve nuk është provuar dhe faktuar dhe nuk ekziston bazë ligjore që të provojë se ka pasur shkelje të natyrës substanciale që mund të ndikojnë në integritetin e procesit zgjedhor ose në rezultatin përfundimtar, andaj mbi barrën e provës dhe standardin ligjor: në mbështetje të nenit 117 paragrafi 3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme: *"Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse, dhe barra e provës bie mbi palën ankuese."*, vlerësoj se dëshmitë e paraqitura nuk krijojnë bazë të mjaftueshme me të cilën për gjykatën do të krijohej bindja që në rastin konkret duhet të urdhërohet rivotimi. Prandaj, edhe PZAP me të drejtë ka vlerësuar se pretendimet e subjektit politik ankues nuk mbështeten në prova faktike apo juridike.

Nga theksimet si më lartë dhe në bazë të nenit 118 paragraf 4, të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

AA.nr.122/2025, më datë 20 nëntor 2025

Kryetar i kolegjit,

Faton Bajrami



15



SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
ANOST OTPRAVKA POTVRDUJE

Punëtori i autorizuar
Dyfishçeni rasnik



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS/ SUDSKI SAVET KOSOVA/ KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

SEKRETARIATI I KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS

SUPREME E KOSOVËS

Sheji i shkresës
Oznaka spisa:

DA-122/2025

LETËDËRGESE PËR DORËZIM PERSONAL

DOSTAVNICA ZA LICNO DOSTAVLANJE

PZAP-

PRISTIN

si marrësi, i cili me tentimin e parë të dorëzimit nuk u gjet në ku është dashtë të bëhet dorëzimi I sa pas lënjes së lajmërimit m që për shkak të dorëzimit të gjendet në kohën e caktuar në apo në vendin e punës së tij, dorëzimi është bërë: nadhor të familjes së marrësit - kujdestarit të ndërtesës, fqjut, it që punon po n'atë vend me marrësin.

o primilac, koji pri prvom pokusajo dostave nije zatecen na mestu stavljanje ima izvršiti ni posle ostavljenog pismenog obavestenja stavljanja bude u odredjeno vreme u svom stanu radnom mestu, : izvršena; odraslom clanu domacin. Primaoca nastojniku zgrace licu zaposlenom na istom radnom mestu primaocem

si marrësi ose anëtar i familjes së tij e refuzon marrjen e shkresa u la në banesë në vendin e punës së marrësit (duke e derën e banesës ose të lokalit ku gjendet në punë marrësi).

o primilac odnosno clan njenog domacinstva odbio prijem, pismo leno u stanu - radnom mestu primaoca (pribieno na vratima sno prostorije gde primilac zaposlen)

11.2025 201 në ora 10:30 u cas.

efuzimit të marrjes
bijanja prijmea

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljača

Emri i shkresës që dorëzohet:

Naslov pisma koja se dostavlja:

AKTGURIM

20.11.2025

Numri i shtojcave:

2

broj priloga

Vërtetoi se mora shkresën e lartëpërmendur
më (me fjalë)

Povrdujemo prijem gorenavegenog pisma
(i slovima)

Wadi

(Nënshkrimi i marrësit ose i atij që
e ka marrë aktin në vend të tij
Potpis primioca ili lica koje je
pismeno primilo u zamenu)

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljača

Në rast se marrësi është analfabet ose nuk është në gjendje të nënshkruajë dorëzuesi, duke shkruar shkaktun pse marrësi nuk e ka vënë nënshkrimin e vet. Ako je primilac nepismen ili nije u stanju da se potpiše, potpisuje ga dostavljač, napomenom zasto primilac nije stavio svoj potpis.

Fm 1203